



Prishtinë, 31 mars 2016
Kodi i ZRRE: V_797_1_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit)
- Vendimi nr V_516_2013 për Të Hyrat Maksimale Të Lejuara (MAR) që do të mbulohen nga operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës A dhe operatorit të licencuar të Termocentralit të Kosovës B (Gjeneratorët e Rregulluar) përmes ngarkesave për ofrimin e energjisë dhe kapacitetit;
- Aplikacionin e KEK-Gjenerimit të dorëzuar me datën 04 dhjetor 2015, në kuadër të Shqyrtimit të Dhjetë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE10) me dokumentacionin relevant sqarues.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur më 31 mars 2016 nxori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (MAR) që do të mbulohen nga operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës A dhe operatorit të licencuar të Termocentralit të Kosovës B (Gjeneratorët e Rregulluar) përmes ngarkesave për ofrimin e energjisë dhe kapacitetit për Furnizuesin Publik me energji elektrike për vitin relevant tarifor SHTE10.

ARSYETIM


- ✚ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga Korporata e Energjisë Elektrike e Kosovës SH.A. (KEK) aplikacionin e KEK-Gjenerimit, për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale që duhet mbledhur nga Gjeneratorët e Rregulluar përmes ngarkesave për energji dhe kapacitet.
- ✚ Në marrjen e vendimit që MAR të rimerret nga Gjeneratorët e Rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
 - Vlerësimi i përfundimtar – Vlerësim i detajuar i Gjenerimit të KEK-ut, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Vlerësimi i përfundimtar-Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
 - Raport Konsultativ – Llogaritja e Kostos së Blerjes me Shumicë të Energjisë Elektrike, i publikuar më datën 24 Shkurt 2016;
 - Raport Konsultativ - Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Ngarkesave të Gjenerorit të Rregulluar, i publikuar me datën 24 shkurt 2016; dhe





- Përgjigjet ndaj Komenteve - Shqyrtimi i dhjetë i tarifave të energjisë elektrike SHTE9, i publikuar me datën 31 mars 2016.
- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulojnë nga Gjeneratorët e Rregulluar "TC Kosova A dhe B" për vitin relevant tarifor SHTE10 janë **147,495,725** euro.
- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për Gjeneratorët Rregulluar do t'i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës për vendosjen e çmimeve të gjenerimit.
- IV. Të Licencuarit për Gjeneratorët e Rregulluar duhet t'i përgatisin dhe dorëzojnë për aprovim ZRRE-së ngarkesat për kapacitet dhe energji për mbulimin e të hyrave të Lejuara Maksimale të përcaktuara me këtë Vendim, brenda një afati sa më të shkurtër.
- V. Ngarkesat e propozuara nga të licencuarit duhet ndjekur parimet e vendosura në Rregullin për Çmimet e Gjenerimit dhe Metodologjia e Përcaktimit të Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar.
- VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhës shqipe.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës A dhe operatorit të licencuar të Termocentralit të Kosovës B duke filluar nga 1 prilli 2016 deri në shqyrtimin e rregulltar tarifor, dhe do të publikohet në uebfaqen zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit

Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar,


Arsim Janova, anëtar,


Qemaj Mustafa anëtar,


Besim Sejfi anëtar.

Vendimi iu dërgohet:

- Palës, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.